

# LegalNews

Korrik 2018  
July 2018



**I. Vendim i Keshillit te Ministrave nr. 434, date 11.07.2018 "Per etiketimin e ushqimeve dhe informimin e konsumatorit"**

Këshilli i Ministrave miratoi më datë 11.07.2018, vendimin nr. 434 "Për etiketimin e ushqimeve dhe informimin e konsumatorit" ("**Vendimi**"). Vendimi është botuar në Fletoren Zyrtare numër 106, datë 19.07.2018 dhe do të hyjë në fuqi 2 (dy) vite pas botimit në këtë fletore.

Vendimi përaftron pjesërisht kuadrin rregullator kombëtar për informacionin ushqimor me Rregulloren nr. 1169/2011 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 25 tetor 2011 "Për dhënien e informacionit ushqimor për konsumatorët" dhe synon të sigurojë një nivel të lartë të mbrojtjes së konsumatorit nëpërmjet informacionit për ushqimin, në veçanti lidhur me etiketimin e produkteve ushqimore.

Vendimi përcakton ndër të tjera, kategoritë për të cilat ky vendim është i zbatueshëm, të tilla si:

- Operatorët e biznesit ushqimor, kur aktiviteti i tyre ka të bëjë me dhënien e informacionit për ushqim për konsumatorët;
- Të gjitha ushqimet e destinuara për konsumatorin fundor;
- Shërbimet e *catering-ut* të ofruara nga ndërmarrjet e transportit.

**I. Decision of Council of Ministers no. 434, dated 11.07.2018 "On food labelling and information of consumer"**

On 11.07.2018, the Council of Ministers approved the decision no. 434 "On food labelling and information of consumer" ("**Decision**"). The Decision has been published with the Official Gazette no. 106, dated 19.07.2018 and will become effective after 2 (two) years from its publication with the said gazette.

This Decision approximates partially the national regulatory framework on food information with Regulation no.1169/2011 of the European Parliament and of the Council, dated 25 October 2011 "On the Provision of Food Information to Consumers" and aims to ensure a high level of protection of consumers through food information, particularly food labelling.

The Decision determines, inter alia, the categories within its scope of application, such as:

- Food business operators, where their activity concerns the provision of food information to the consumers;
- All foods intended to the final consumer;
- Catering services provided by transport undertakings.

Ne baze te Vendimit, çdo produkt ushqimor i ambalazhuar paraprakisht, që është i destinuar për konsumatorin e fundit ose për shërbimin *catering*, duhet të përmbajë informacionin ushqimor të detyrueshëm (veçori të detyrueshme), të listuara në vijim:

- emrin e produktit ushqimor,
- listën e përbërësve,
- çdo përbërës që shkakton alergji ose intolerancë,
- sasinë e përbërësve përkatës,
- sasinë neto të produktit ushqimor,
- datën e jetëgjatësisë minimale,
- kushtet e veçanta të ruajtjes dhe/ose përdorimit,
- emrin ose emrin tregtar dhe adresën e operatorit të biznesit ushqimor,
- shtetin e origjinës ose vendin e prejardhjes,
- udhëzimet e përdorimit,
- fortësinë aktuale alkoolike për pijet me mbi 1.2% të vëllimit me alkool, si dhe
- deklaratën e vlerave ushqyese.

Përveç sa me sipër, veçori shtesë, të detyrueshme, për lloje dhe kategori specifike të produkteve ushqimore janë të pasqyruara në shtojcën III bashkëlidhur këtij Vendimi.

Pursuant to the Decision, any food pre-packed, which is intended to the final consumer or catering service should be accompanied with the mandatory food information (mandatory particulars), that includes:

- the name of the food product,
- the list of ingredients,
- any ingredient causing allergies or intolerances,
- quantity of certain ingredients,
- net quantity of the food product,
- data of minimum duration,
- any special storage conditions and/or conditions of use,
- the name or trade name and address of the food business operator,
- the country of origin or place of provenance,
- instructions for use,
- the actual alcoholic strength for beverages containing more than 1.2% of volume with alcohol, as well as,
- the nutrition declaration.

Regarding to the specific types and categories of food, the Decision provides for additional mandatory particulars on the attached Appendix III.

Gjithashtu, Vendimi parashikon se, me përjashtim të përbërësve që shkaktojnë alergji ose intolerancë, informacioni i detyrueshëm i cituar më sipër për produktet e ambalazhuara nuk është i detyrueshëm të paraqitet në rastet kur produktet ushqimore ofrohen tek konsumatori i fundit ose te shërbimi *catering*, pa ambalazhimin paraprak, kur produktet ushqimore paketojnë në ambientet e shitjes me kërkesë të konsumatorit apo kur ambalazhohen paraprakisht për shitje direkte. Për produktet ushqimore të ofruara për shitje nëpërmjet komunikimit në distancë (shitja në distancë) të gjitha veçoritë e detyrueshme paraqiten në momentin e dërgesës.

Parashikime të tjera të Vendimit lidhen me paraqitjen e detajuar të secilës prej veçorive të detyrueshme ku ndër të tjera, parashikohet se informacioni ushqimor i detyrueshëm duhet të shënohet në një mënyrë të dallueshme, lehtësisht të dukshme dhe qartësisht të lexueshme.

Paraqitja dhe saktësia e informacionit ushqimor janë përgjegjësi e operatorit të biznesit ushqimor, i cili krahas kësaj ka edhe detyrime të tjera në të gjitha fazat e zinxhirit ushqimor të tilla si: transmetimi i informacionit të produktit që nuk është ambalazhuar tek operatori i radhës i biznesit ushqimor që e merr këtë produkt apo notifikimi i etiketës me informacionin ushqimor tek AKU.

Vendimi përcakton edhe penalitetet që do të zbatohen në rastet kur ka shkelje të dispozitave të aplikueshme nga ana e subjekteve, si rrjedhojë e kësaj ushqimet që nuk shoqërohen me informacionin ushqimor përkatës do të bllokohen dhe asgjësohen, në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 9863, datë 28.01.2008 "Për ushqimin" i ndryshuar.

Moreover, the Decision provides that, with the exception of the ingredients causing allergies or intolerances, the mandatory information as above is not obligatory in cases when the foods are provided to the final consumer or catering service without pre-package, when the food is packed in the selling premises on the request of the consumer or when the food is packed in advance for direct selling. In the cases of prepacked foods offered for sale by means of distance communication (distance selling), the mandatory particulars are made available at the moment of the delivery.

Other provisions of the Decision regulate in detail the presentation of each of the mandatory particulars, where *inter alia*, it prescribes that such food information should be marked in a conspicuous place, in such a way as to be easily visible and clearly legible.

The presentation and accuracy of food information are under the responsibility of the food business operator, who has also other responsibilities at all stages of the food chain, like for instance: the transmitting of food information regarding non pre-packed food to the following food business operator, which receives such product and the notification of the label including food information delivered to AKU.

The Decision provides also for the penalties that will be applied in the event of breach of applicable provisions, determining that the food lacking the mandatory and respective information will be blocked and destroyed, in accordance with the provisions of the law no. 9863, dated 28.01.2008 "On food" as amended.

Me hyrjen në fuqi, ky Vendim do të shfuqizojë vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 1344, datë 10.10.2008 "*Për miratimin e rregullave "Për etiketimin e produkteve ushqimore"*". Organet kompetente të ngarkuara për zbatimin e Vendimit janë Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural si dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Upon its entry on force, this Decision will repeal decision of Council of Ministers no.1344, dated 10.11.2008 "*On the approval of rules "On food labelling"*". The Ministry of Agriculture and Rural Development and the National Food Agency will be the responsible bodies for the application of this Decision.

**II. Vendim i Këshillit Drejtues të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare nr.41, datë 04.06.2018 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Rregulloren nr.2, datë 21.02.2008 "Për regjistrimin dhe administrimin e emrave të domain-eve nën .al dhe nëndomain-et .gov.al, .mil.al, .edu.al, .com.al, .org.al dhe .net.al" i ndryshuar**

Këshilli Drejtues i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare ("**AKEP**") ka miratuar vendimin nr. 41, datë 04.06.2018 "*Për disa shtesa dhe ndryshime në Rregulloren nr. 2, datë 21.02.2008 "Për regjistrimin dhe administrimin e emrave të domain-eve nën .al dhe nëndomain-et .gov.al, .mil.al, .edu.al, .com.al, .org.al dhe .net.al" i ndryshuar ("**Vendimi**")*.

Vendimi është publikuar në faqen zyrtare elektronike të AKEP ([www.akep.al](http://www.akep.al)) dhe ka hyrë në fuqi në datën e miratimit të tij.

Nder te tjera, Vendimi parashikon se regjistruues do të jenë AKEP dhe subjektet e regjistruara pranë këtij të fundit për të bërë regjistrimin e emrave të domain-ve nën ".al" ("**Regjistruues**"). Ndërkohë, aktivizimi i emrave të domain-eve kryhet nga AKEP pasi është bërë shqyrtimi i aplikimit dhe ka rezultuar në përputhje me rregulloren.

AKEP dhe Regjistruesit duhet të mbajnë në website e tyre, linkun e faqes zyrtare elektronike të Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Industriale, e cila mundëson kërkimin për marka/patenta të regjistruara, në mënyrë që emri i domain-it të kërkuar të mos jetë markë ose patente e regjistruar.

**II. Decision of The Steering Board of the Electronic and Postal Communications Authority adopted the decision no.41, dated 04.06.2018 "On some additions and amendments to the Regulation no.2, dated 21.02.2008 "On the registration and administration of the domain names under .al and subdomain names .gov.al, .mil.al, .edu.al, .org.al and .net.al" as amended**

The Steering Board of the Electronic and Postal Communications Authority ("**AKEP**") adopted the decision no. 41, dated 04.06.2018 "*On some additions and amendments to the Regulation no. 2, dated 21.02.2008 "On the registration and administration of the domain names under .al and subdomain names .gov.al, .mil.al, .edu.al, .org.al and .net.al" as amended ("**Decision**")*.

The Decision has been published in the official website of AKEP ([www.akep.al](http://www.akep.al)) and entered into force on the date of its adoption.

Inter alia, the Decision provides that the role of registrars shall be covered by AKEP and other entities registered with the latest to perform the registration of domain names under ".al" ("**Registrar**"). Meanwhile, the activation of the domain names shall be performed by AKEP after the review of the application and its compliance with the regulation.

AKEP and the Registrars should maintain in their websites, the link to the website of the General Directorate of Industrial Property, which enables the search for registered trademarks/patents, in order to avoid that the required domain name being a registered trademark or patent.

Në rast se një emër domain-i nën “.al” i regjistruar do të përkojë saktësisht me emrin e një marke/patente dhe në rast se poseduesi i markës/patentës aplikon për të njëjtin emërtim emri domain-i nën “.al”, AKEP çregjistron emrin e domain-it dhe e regjistron për kërkuesin që zotëron markën/patentën.

Më tej, Vendimi parashikon një numër maksimal emrash domain-i të cilët mund të zotërohen, deri në 5 për individët dhe deri në 15 për subjektet fizike dhe juridike, me kushtin që të vendosen në përdorim brenda një afati 1 vjeçar. Në rast se për nevoja teknike, tregtare etj., të arsyetuara, kërkohet të regjistrohen më shumë emra domain-sh nën “.al”, regjistrimi shtesë bëhet vetëm me miratim të AKEP.

Afati për regjistrimin e emrit të domain-it nën “.al” (dhe nëndomain-eve), i cili kryhet nga AKEP dhe Regjistruesit, është deri në 3 ditë pune, i përlogaritur nga momenti i paraqitjes së formularit të rregullt të aplikimit.

Për modifikimin/transferimin/mbylljen e emrit të domain-it nën “.al” nga AKEP dhe Regjistruesit, afati është 3 ditë pune nga momenti i paraqitjes së formularit të rregullt të aplikimit.

Vendimi shton disa kritere të zbatueshme për Regjistruesin, si:

- a. Regjistruesi duhet të ketë në objekt të aktivitetit të tij të regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit (“**QKB**”) edhe regjistrimin e emrave të domain-eve nën “.al” dhe nëndomain-eve.

In case the registered domain name will coincide exactly with the name of a registered trademark/patent and if the holder of the trademark files an application for the same domain name under “.al”, AKEP deregisters the domain name and registers it for the applicant owning the registered trademark/patent.

Furthermore, the Decision provides for a maximum number domain names to be owned, up to 5 for individuals and up to 15 for natural and legal persons, provided that such domains are used within 1-year. In case of reasoned technical, commercial, etc., is required to register more domain names under “.al”, the additional registration is only performed with the approval of AKEP.

The term for the registration of the domain name under “.al” (and subdomains), performed by AKEP and Registrars, is up to 3 business days, calculated from the moment of the submission of the regular application form.

The term for the modification/transfer/deletion of the domain name under “.al” from AKEP and the Registrars is up to 3 business days from the submission of the correct application form.

The Decision adds several criteria applicable to the Registrar, such as:

- a. The Registrar must reflect in its object of activity registered with the National Business Center (“**NBC**”) the registration of domain names under “.al” and subdomain names.



- b. Regjistruesit aktualë në AKEP, që nuk kanë të regjistruar si objekt aktiviteti në QKB regjistrimin e emrave të domain-eve nën “.al” dhe nëndomain-eve nën “.al”, duhet brenda 45 ditë nga hyrja në fuqi e Vendimit të kryejnë regjistrimin dhe të dorëzojnë ekstraktin historik pranë AKEP.
- c. Regjistruesit aktualë, duhet të paraqesin në AKEP, brenda 30 ditëve, konfirmimin e Regjistrimit pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (“**KDIMDP**”).
- d. Regjistruesi duhet disponojë faqe zyrtare elektronike me emrin e domain-it nën “.al” ose nëndomain-in “.al”, brenda 30 ditëve nga regjistrimi në AKEP, në gjuhën shqipe të shoqëruar me shënimin që është i regjistruar pranë KDIMDP, etj.

Në vijim, Vendimi parashikon se Regjistruesi, nder te tjera, detyrohet te:

- a. ofrojë mundësinë e kërkimit për emra domain-i nën “.al” dhe nëndomain-e, brenda 30 ditëve nga regjistrimi i tij pranë AKEP.
- b. mbaje të publikuar dhe të përditësuar, gjatë gjithë kohës së regjistrimit në AKEP, rregulloren e AKEP në fuqi për regjistrimin dhe administrimin e emrave të domain-eve nën “.al” dhe nëndomain-eve si edhe listën e emrave të ndaluar dhe të rezervuar të miratuar e përditësuar nga AKEP.

- b. Current Registrars, who have not registered with the NBC, the registration of domain names under “.al” and subdomain names under “.al” should perform registration within 45 days from the entry into force of the Decision and submit the historical excerpt with AKEP.
- c. Current Registrars must submit to AKEP, within 30 days, the confirmation of registration with the Commissioner for the Right of Information and Protection of Personal Data (“**KDIMDP**”).
- d. The Registrar should have in place a website with the domain name under “.al” or subdomain “.al”, within 30 days upon the registration with AKEP, in Albanian language accompanied by an information note that is registered with KDIMDP, etc.

In addition, the Decision stipulates that *inter alia*, the Registrar is obligated to:

- a. offer the possibility of search for the domain names under “.al” and subdomains, within 30 days upon its registration with AKEP.
- b. keep published and up-to-date, throughout the time of its registration with AKEP, the AKEP regulation in force on the registration and administration of domain names under “.al” and subdomains as well as the list of reserved and prohibited names as approved and updated by AKEP.



- c. vendose një shënim në faqen zyrtare elektronike që është i regjistruar pranë KDIMDP dhe që zbaton detyrimet dhe përcaktimet që burojnë nga ligji nr. 9887, datë 10.03.2008 "*Për mbrojtjen e të dhënave personale*" i ndryshuar.

Vendimi ka ndryshuar dhe afatet përkatëse në lidhje me transferimin e emrit të domain-it duke reduktuar ndër të tjera afatet e parashikuara nga 30 ditë kalendarike në 5 ditë pune.

Në lidhje me detyrimet e raportimit, Vendimi parashikon se Regjistruesit, çdo 3 muaj duke filluar nga muaji Mars i çdo viti, duhet të dorëzojnë pranë AKEP, në formë elektronike ose të printuar, të gjithë formularët e veprimeve dhe raportet me problematikat e hasura me emrat e domain-ve nën ".al", të shoqëruara me dokumentacionin e nevojshëm për sqarime.

- c. publish an information note on its website stating that its registered with the KDIMDP and that applies the obligations and requirements of the law no. 9887 dated 10.03.2008 "*On personal data protection*" as amended.

The Decision has also amended the relevant terms with regard to domain name transfer by reducing such term from 30 calendar days to 5 business days.

With regard to reporting obligations, the Decision provides that the Registrars, every 3 months starting from March of each year, should submit with AKEP, in electronic or hard copy, all standard forms and reports reflecting the problems encountered with the domain names under ".al", accompanied by the necessary documentation for clarification.

## Deloitte Contacts

### **Olindo Shehu, CPA**

Partner | Tax & Legal Services  
Deloitte Albania sh.p.k

Rr. "Elbasanit", Pallati prane Fakultetit  
Gjeologji Miniera  
Tirana | Albania  
Mob: +355 68 60 33 116  
E-mail: [oshehu@deloitteCE.com](mailto:oshehu@deloitteCE.com)

### **Disclaimer:**

This publication contains general information only, and none of Deloitte Touché Tohmatsu Limited, any of its member firms or any of the foregoing's affiliates (collectively the "Deloitte Network") are, by means of this publication, rendering accounting, business, financial, investment, legal, tax, or other professional advice or services.

This publication is not a substitute for such professional advice or services, nor should it be used as a basis for any decision or action that may affect your finances or your business. Before making any decision or taking any action that may affect your finances or your business, you should consult a qualified professional adviser. No entity in the Deloitte Network shall be responsible for any loss whatsoever sustained by any person who relies on this publication.

No entity in the Deloitte Network shall be responsible for any loss whatsoever sustained by any person who relies on this publication.

\*\*\*

Deloitte refers to one or more of Deloitte Touché Tohmatsu Limited, a UK private company limited by guarantee, and its network of member firms, each of which is a legally separate and independent entity. Please see [www.deloitte.com/al/about](http://www.deloitte.com/al/about) for a detailed description of the legal structure of Deloitte Touché Tohmatsu Limited and its member firms.

Deloitte provides audit, tax, consulting, and financial advisory services to public and private clients spanning multiple industries. With a globally connected network of member firms in more than 150 countries, Deloitte brings world-class capabilities and deep local expertise to help clients succeed wherever they operate. Deloitte's approximately 263,900 professionals are committed to becoming the standard of excellence.